

**RELACION SHPJEGUES PËR  
PROJEKTLIGJIN  
“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9374, DATË 21.04.2005 “PËR  
NDIHMËN SHTETËRORE”, I NDRYSHUAR”**

**I. QËLLIMI I PROJEKT-LIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË  
ARRIHEN.**

Projektligji ka për qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e ndihmës shtetërore, në përputhje me detyrimin për të përafuar më tej legjislacionin shqiptar me atë të “*acqui communautaire*”. Miratimi i këtij projektakti vjen si domosdoshmëri për të reflektuar, në legjislacionin e brendshëm, disa ndryshime që ka pësuar legjislacioni i Bashkimit Evropian në fushën e ndihmës shtetërore, si dhe rekomandimet e Progres Raporteve të Komisionit Evropian për kontrollin e ndihmës shtetërore në Shqipëri.

Projektligji synon përafrimin më tej të kuadrit ligjor shqiptar të ndihmës shtetërore me Acquis të BE-së, duke u fokusuar veçanërisht në kërkesat e Direktivës (BE) 2019/1 (Direktiva ECN+) lidhur me pavarësinë e autoriteteve kombëtare dhe Rregulloren e Këshillit (BE) 2015/1589, e cila përcakton rregulla të detajuara për zbatimin e Nenit 108 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE).

Qëllimi kryesor i këtij projektligji është ristrukturimi i Komisionit të Ndihmës Shtetërore (KNSH) deri më sot, nëpërmjet krijimit dhe funksionimit të Autoritetit të Kontrollit të Ndihmës Shtetërore për të garantuar pavarësinë institucionale dhe operacionale. Ndryshimet e shndërrojnë strukturën aktuale në një organ publik të pavarur, duke përmirësuar linjat e raportimit dhe hierarkinë administrative.

Në Raport Progresin për Shqipërinë 2025, të Komisionit Evropian për Kapitullin 8 “Politika e Konkurrencës”, ka rekomanduar si vijon:

- të sigurojë pavarësinë operacionale të KNSH dhe të rrisë ndjeshëm kapacitetin administrativ të sekretariatit të KNSH;
- të harmonizojë më tej kornizën legjislative në fushën e ndihmës shtetërore me acquis e BE-së;
- të bëjë përpjekjet për të rritur ndërgjegjësimin e KNSH në lidhje me ministritë e linjës, autoritetet rajonale dhe vendore në mënyrë që të sigurohet njoftimi paraprak i masave të ndihmës dhe të forcohet zbatimi i rregullave të ndihmës shtetërore.

Gjithashtu, në zbatim të VKM nr. 621, datë 10.10.2024 “Për miratimin e dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027” në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”, është parashikuar detyrimi për “Miratimin e kuadrit ligjor për të siguruar një Autoritet, me pavarësi operacionale, të Ndihmës Shtetërore dhe i masave operacionale përkatëse (buxheti) (Dhjetor 2025).

Ndërhyrjet kryesore të projektligjit të propozuar përfshijnë:

- *Pavarësinë Institucionale dhe riorganizimi*: Projektligji përcakton Autoritetin e Kontrollit të Ndhmës Shtetërore si një person juridik, të pavarur në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të tij. Projektligji ndryshon strukturën e mëparshme të bazuar në komisionin e Ndhmës Shtetërore (KNSH) në një Këshill Drejtues të përhershëm dhe një Sekretariat të dedikuar, duke siguruar një ndarje të qartë nga qeverisja e ekzekutivit, konkretisht nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit.
- *Përzgjedhjen e bazuar në meritë dhe integriteti*: Janë vendosur kritere rigorozë për zgjedhjen e pesë anëtarëve të Këshillit Drejtues. Kandidatët duhet të kenë të paktën 10 vite përvojë profesionale, me ekspertizë të veçantë në të drejtën e konkurrencës dhe ndihmën shtetërore, si dhe duhet të dëshmojnë njohuri të thella të legjislacionit të BE-së. Për të garantuar integritetin profesional, ligji kërkon një verifikim të rreptë të paanësisë politike dhe interesave ekonomike gjatë 5 viteve para emërimit.
- *Përafrimi me Direktivën ECN+ (Shkaqet e lirimit nga detyra)*: Në përputhje me standardet e BE-së, Neni 16/4 parashikon që anëtarët e Këshillit Drejtues mund të shkarkohen vetëm mbi baza objektive, të përcaktuara ligjërisht, siç janë shkeljet e rënda të ligjit ose paaftësia fizike, duke i mbrojtur ata nga shkarkimet arbitrare politike.
- *Konflikti i interesit dhe periudha e ndalimit ("Cooling-off")*: Parashikohet një periudhë të detyrueshme ndalimi dy-vjeçare ("cooling-off"). Kjo parandalon ish-anëtarët që të përfaqësojnë subjekte private përpara Autoritetit ose të punësohen nga ndërmarrje për të cilat kanë marrë vendime gjatë mandatit të tyre.
- *Fuqizimi i kompetencave ekzekutive (sanksionet administrative)*: Sipas dispozitave të Rregullores (BE) 2015/1589, Autoritetit i jepet kompetenca për të vendosur gjopa administrative deri në 1% të qarkullimit (xhiros) gjithsej vjetor për dhënien e informacionit të pasaktë ose mashtrues, dhe gjopa periodike deri në 5% të qarkullimit mesatar ditor për moszbatim të kërkesave për informacion.
- *Autonomia financiare dhe operationale*: Për të siguruar që Autoriteti të ketë burime të mjaftueshme për të kryer detyrat e tij në mënyrë efektive, projektligji parashikon krijimin e një zëri të veçantë buxhetor brenda buxhetit të shtetit, të miratuar drejtpërdrejt nga Kuvendi. Për më tepër, Autoriteti autorizohet të nxjerrë udhëzues dhe instrumente ligjore interpretuese në përputhje të plotë me TFBE-në dhe praktikat më të mira të Komisionit Evropian.

Zbatimi i këtij projektligji përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt përmbushjes së detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA).

Duke forcuar pavarësinë dhe kapacitetet ekzekutive të Autoritetit të Kontrollit të Ndhmës Shtetërore, projektligji garanton kushte të barabarta konkurrence në treg dhe ofron garancitë e nevojshme ligjore si për komunitetin e biznesit ashtu edhe për dhënësit e ndihmës, në përputhje me *acquis* e Bashkimit Evropian për kontrollin e ndihmës shtetërore.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE.**

Projektligji është në përputhje me programin politik të Qeverisë për nismat ligjore dhe nënligjore që duhen ndërmarrë për të përgatitur dhe zbatuar politikat e qeverisë në sferën ekonomike, si dhe zbatimi me korrektësi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), pjesë e së cilës është fusha e ndihmës shtetërore, në kuadër të procesit të aderimit të Shqipërisë në BE.

Projektligji i propozuar është parashikuar në programin analitik të projekt-akteve 2026 të miratuar për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.**

Miratimi i këtij projektligji parashikohet të ketë një ndikim të rëndësishëm në mbrojtjen e konkurrencës nga çdo formë e ndërhyrjes së shtetit, nëpërmjet të cilave synohet mbështetja apo dhënia e lehtësirave për një ndërmarrje apo sektorë të veçantë.

Ky projektligj parashikon disa koncepte të reja që zbatohen në BE të nevojshëm për zbatimin e ligjit dhe vendimmarrjen e strukturave përgjegjëse. Gjithashtu, ligji propozon një ndryshim në përbërjen e Komisionit të Ndihmës Shtetërore duke e zëvendësuar me krijimin dhe funksionimin e Autoritetit të Kontrollit të Ndihmës Shtetërore, me qëllim forcimin e pavarësisë në vendimmarrje sa i takon fushës së ndihmës shtetërore.

### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.**

Projektligji hartohet në bazë të nenit 78 dhe 83 të Kushtetutës së RSH dhe paraqitet si një nismë me propozim të Këshillit të Ministrave. Përgatitja e këtij projektligji është në përputhje me nenin 71, pika 1 (iii) dhe pika 4 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë.

Ky projektligj propozon një reformë të thellë që do të ketë nevojë nxjerrjen e disa akteve të reja nënligjore dhe udhëzime teknike nga Këshilli Drejtues i Autoritetit të Kontrollit të Ndihmës Shtetërore (sipas Nenit 10), pasqyrimi i plotë i shkallës së përafrimit me Rregulloren (BE) 2015/1589 do të jetë shterues në momentin e finalizimit të të gjithë kuadrit plotësues ligjor, i cili do të garantojë krijimin dhe funksionimin e autoritetit të pavarur të ndihmës shtetërore në përputhje me nenin 71, të MSA.

### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Projektligji është bazuar në Rregulloren e Këshillit nr. 2015/1589 (BE) e 13 korrikut 2015 “Mbi përcaktimin e rregullave të hollësishme për zbatimin e Nenit 108 të Traktatit mbi Funksionimin e

Bashkimit Evropian. Përafrimi me këtë akte është i pjesshëm sepse ato do të përafrohen më tej nëpërmjet akteve nënligjore nëpërmjet Autoritetit të Kontrollit të Ndihmës Shtetërore.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Ky projekt ligj ka përmbajtjen si vijon:

**Neni 1:** Ky nen përkufizon konceptin e “Ndihmës së paligjshme”, si çdo ndihmë shtetërore, që jepet dhe zbatohet në kundërshtim me këtë ligj ose në kundërshtim me vendimet e marra nga Autoriteti për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore. Gjithashtu përkufizohet edhe “Ndihmë shtetërore për shpëtim” si një mbështetje financiare për një ndërmarrje në vështirësi, për një periudhë kohore, gjatë së cilës duhet të përgatitet plani i ristrukturimit ose i likuidimit.

**Neni 2:** Përcaktohet detyrimi që planet e ristrukturimit, pas miratimit nga institucioni dhënës, t'i nënshtrohen shqyrtimit dhe vendimmarrjes nga Autoriteti për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore.

**Neni 3:** Transformon Komisionin e Ndihmës Shtetërore në Autoritetin për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, si një organ publik, të pavarur dhe person juridik me seli në Tiranë. Struktura organizative ndahet në dy nivele: Këshilli Drejtues (organi vendimmarrës) dhe Sekretariati (organi ekzekutiv-teknik).

**Neni 4:** Ky parashikon dispozita lidhur me garantimin e pavarësinë operacionale:

- Këshilli përbëhet nga 5 anëtarë me mandat 5-vjeçar, të zgjedhur nga Kuvendi përmes kandidaturave alternative (nga Presidenti, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave).
- Vendosen kritere të larta profesionale (10 vite përvojë) dhe integriteti (deklarim i interesave ekonomike, kontroll nga ILDKPKI dhe certifikatë sigurie).
- Parashikohen rregulla abstenimi dhe ndalimi i punësimit në subjekte përfituese për 2 vite pas përfundimit të mandatit.

**Neni 5:** Parashikohen dispozita mbi funksionet e Këshillit Drejtues të Autoritetit, ku përfshihen: hartimi i politikës kombëtare, autorizimi i skemave të ndihmës etj. Gjithashtu nëpërmjet nenit 17/1 përcaktohet rregulli i kuorumit (4 anëtarë) dhe detyrimi për votim pro ose kundër, duke eliminuar mundësinë e abstenimit.

**Neni 6:** Parashikon dispozita që rregullojnë veprimtarinë e Sekretariatit nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm, me fokus në proceset hetimore dhe mbajtjen e regjistrit të ndihmës. Një pikë kyçe është pavarësia buxhetore; Autoriteti do të ketë buxhetin e tij si zë i veçantë në Buxhetin e Shtetit.

**Neni 7:** Parashikon dispozita lidhur me pajisjen e Autoritetit me kompetenca ndëshkuese. Parashikohen gjopa deri në 1% të qarkullimit vjetor për dhënie informacioni të pasaktë dhe gjopa ditore deri në 5% të xhiros mesatare për vonesa në dorëzimin e të dhënave të kërkuara.

**Neni 8:** Përcakton afatin e fundit më 30 qershor për dorëzimin e raportit vjetor në Kuvend, duke rritur llogaridhënien për zbatimin e skemave të ndihmës dhe ndihmave individuale të dhëna gjatë vitit paraardhës.

**Neni 9:** Ky nen siguron kalimin institucional të kompetencave nga strukturat ekzistuese (Komisioni dhe Drejtoria) te Autoriteti i ri i pavarur, duke shmangur boshllëkun ligjor gjatë periudhës së tranzicionit.

**Neni 10:** Ngarkon Këshillin Drejtues të Autoritetit për nxjerrjen e udhëzimeve teknike në përputhje me legjislacionin e BE-së, duke garantuar përditësimin e vazhdueshëm me aktet ligjore të Bashkimit Evropian.

**Neni 11:** Parashikon që ligji të fillojë zbatimin 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI.**

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit si institucion propozues i projektligjit për krijimin e Autoritet të ri për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore.

Përveç zgjerimit të kompetencave vendimmarrëse, projektligji ngarkon Autoritetin e ri me detyrimin për zbatimin e legjislacionit të ndihmës shtetërore dhe sigurimin e transparencës përfshirë detyrimin për raportim vjetor pranë Kuvendit të Shqipërisë.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT.**

Për hartimin e këtij projektligji ka kontribuar Drejtoria e Politikave të Nxitjes së Biznesit me asistencën e projektit të GIZ SANEKA.

Projektligji do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Ministrin e Shtetit dhe Kryenegociator dhe Autoritetit të Konkurrencës.

Ky projektligj nuk ka mbivendosje ligjore dhe nuk është pjesë e procesit të derregullimit.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE.**

Ky projekt ligj parashikon efekte shtesë në buxhetin e shtetit, të cilat janë si rezultat i ndryshimit institucional të Autoritetit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore në një organ publik të pavarur. Këto kosto specifike lidhen me:

- Shpenzimet e personelit: Rekrutimi i 5 anëtarëve të Këshillit Drejtues me kohë të plotë, paga e të cilëve caktohet nga Kuvendi, si dhe forcimi i kapaciteteve të Sekretariatit me nëpunës civilë shtesë.
- Kostot operative: Shpenzime për sigurimin e selisë së re, infrastrukturës teknologjike dhe logjistikës së nevojshme për funksionimin e pavarur të institucionit.

Këto kosto do të përballohen përmes zërit të veçantë në Buxhetin e Shtetit akorduar këtij Autoriteti, si dhe do të balancohen pjesërisht nga të ardhurat që do të gjenerohen nga tarifat e shërbimeve dhe sanksionet administrative (gjobat), të cilat derdhen në Buxhetin e Shtetit sipas parashikimeve të këtij ligji.

Si takon quantifikimit të shpenzimeve në Programin Buxhetor Afatmesëm vlerësojmë si vijon:

1. Shpenzime për personelin: Këshilli Drejtues (5 anëtarë): Përlllogariten pagat për 5 pozicione të nivelit të lartë drejtues (ekuivalent me pagat e anëtarëve të enteve rregullatore të pavarura). Kosto e përlllogaritur është prej 22,000,000 lekë/vit (përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore). Rekrutimi i Sekretariatit me 5-8 specialistë të rinj për të mbuluar funksionet e reja të mbikëqyrjes dhe sanksioneve, me një kosto të përlllogaritur prej 12,000,000 lekë/vit.
2. Shpenzime Korrente: Për sigurimin e ambienteve fizike të Autoritetit (qira, nëse nuk sigurohet nga pronësia shtetërore), pajisjet e zyrës, IT, dhe mirëmbajtjen, kosto e përlllogaritur prej 8,000,000 lekë/vit. Duke qenë se ligji kërkon njohuri të avancuara të legjislacionit të BE-së, nevojitet një fond i dedikuar për kualifikimin e vazhdueshëm të burimeve njerëzore (Këshillit dhe stafit) me një kosto të përlllogaritur prej 3,000,000 lekë/vit.
3. Shpenzime Kapitale (Investime): Krijimi i një platforme online për njoftimin e ndihmës, monitorimin e skemave dhe transparencën e vendimeve (Regjistri i Ndihmës Shtetërore) me një kosto prej (në vitin e parë) prej 10,000,000 lekë.

Tabela Përmbledhëse për fondin shtesë të kërkuar (PBA):

Kategoria e Shpenzimeve	Viti 2025 (Lekë)	Viti 2026 (Lekë)	Viti 2027 (Lekë)
<b>Shpenzime Personeli</b>	34,000,000	34,000,000	35,500,000
<b>Shpenzime Operative</b>	11,000,000	11,000,000	11,500,000
<b>Investime Kapitale</b>	10,000,000	2,000,000	2,000,000
<b>Gjithsej</b>	<b>55,000,000</b>	<b>47,000,000</b>	<b>49,000,000</b>

**MINISTËR**

**Delina Ibrahimaj**